



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr 122/8 Prot

Tiranë më 31.3. 2021

VENDIM

Nr. 3, Datë 30/03/2021

**“PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË PROJEKT BUXHETIT TË VITIT 2021 PËR
UNIVERSITETIN E TIRANËS”**

Referuar Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika h, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 137/2020, datë 26.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, VKM-së Nr.75 datë 12.02.2018 “Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, Udhëzimit të përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, pasi mori në shqyrtim projekt- Buxhetin e hartuar nga Administratori i UT-së mbi propozimet e njëjësive kryesore, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 30.03.2021,

Vendosi:

1. Miratimin paraprak të Projekt-Buxhetit vjetor të Universitetit të Tiranës për vitin 2021 si më poshtë vijon:
 - Miratimin e detajimit të kuatave të buxhetit të konsoliduar (Grant mësimdhënie, të ardhura UT) sipas formularit nr.1 bashkëlidhur.
 - Miratimin e detajimit të shpenzimeve operative sipas formularit nr.2 bashkëlidhur.
 - Miratimin e detajimit të investimeve sipas listës me objektet sipas formularit nr.3 bashkëlidhur.
 - Miratimin e numrit të planifikuar të punonjësve sipas formularit nr.4 bashkëlidhur.
2. Miratimin e ndryshimeve në strukturën dhe reflektimin e tij në buxhet të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Fakultetin e Ekonomisë, Fakultetin e Shkencave Sociale, Rektoratin e UT-së sipas formularit nr. 5 bashkëlidhur.
3. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim në përputhje me nenin 49, pika 1, gërma c, ç të ligjit nr. 80/2015.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof. Dr. Artan Hoxha

